

## K@rtë informatike e RPN

Në klasën tonë, ne kemi mundësi të përdorim mjetet informatike. Kompjuteri dhe interneti janë në dispozicion për të realizuar aktivitete pedagogjike. Së bashku, ne kemi folur për avantazhet dhe rreziqet e këtij mjeti informimi të mrekullueshëm ; po ashtu, jemi njohur edhe me rregullat që përcaktojnë përdorimin e tij.




1. Në shkollë, unë mund të përdor hyrjen në internet vetëm me autorizimin e mësuesit –(es) tim(e). Ai ose ajo mund të verifikojë sitet e vizituara.



2. Në shkollën tonë, hyrja në internet i është rezervuar projekteve dhe punëve shkollore. Unë s'mund të ngarkoj logjisielë, lodra apo muzikë.

3. Gjithçka që unë mund të gjej në internet nuk mund të jetë e vertetë, e kohës apo e besueshme.




4. Kur unë zbuloj në internet gjera që kanë një përmbajtje tronditëse, unë duhet të flas për to me një të rritur tek i cili kam besim.

5. Unë nuk duhet të hap mesazhet ku janë bashkangjitur dokumente nga një dërgues i panjohur. Unë mbaj përgjegjësi për mesazhet që dërgoj.




6. Unë nuk u jap informacione personale (emër, numër telefoni, adresë mesazhi, fotografi) personave që takoj në internet. Unë mund të plotësoj formularë në linjë vetëm atëherë kur tregoj një maturi të madhe.





7. Një numër i madh elementesh që ndodhen në internet janë të mbrojtur nga e drejta e autorit ; unë s'mund t'i përvehtësoj ato lirisht.

8. Gjatë kohës që unë publikoj informacione në internet, për të cilat unë s'jam autor, duhet të citoj burimet e imazheve dhe teksteve që përdor.





9. Në sajtë të internetit, unë mund të hyj në kontakt me një turmë të madhe njerëzish. Duhet të kem parasysht që të mos plagos dikë me qëllim.

10. Unë s'mund të publikoj fyerje, tema raciste apo poshtëruese dhe as imazhe dashakeqe nëpër site, rrethe sociale, forume, libra të artë apo komente blogjesh. E njëjta rregullore aplikohet po ashtu me telefonat portabël. Shpërndarja dhe stokimi i disa lloj të dhënave janë po ashtu të ndaluara.




11. Unë i ruaj fjalëkalimet apo kodet për vehte ; ato janë si çelësat e shtëpisë time. Megjithatë, mësuesit-et e kolegjit kanë mundësi të hyjnë në to dhe të njihen me dokumentat e depozituara.

12. Publikimi i fotografive të personave në Internet s'mund të bëhet pa pëlqimin e tyre ; fotografitë në sitin internet shkollor mund të figurojnë vetëm me emrat e nxënësve.



13. Unë s'kam të drejtë të publikoj të dhëna në sitin e klasës time ose të shkollës time pa autorizimin e mësuesve. Unë nuk i modifikoj faqet e realizuara nga shokët e mij pa dëshirën e tyre.



Të dashur prindër,

Pa dyshim që ju e dini se fëmija juaj përdor kompjuterin dhe internetin në klasë për punë pedagogjike.

Kapaciteti për t'i përdorur mediat, imazhet dhe teknologjitë e informacionit dhe të komunikacionit (MITIC) në mënyrë të përshtatshme, është një kompetencë shumë e rëndësishme, por pa harruar nga ana tjetër reflektimin mbi rreziqet që mund të shfaqen me përdorimin e këtyre mjeteve.

Me qëllim që të zhvillohen kompetencat mediatike të nxënësve, janë të domosdoshme disa rregulla dhe detyra që përcaktojnë përdorimin e internetit në shkollë. Karta që do të gjeni mbrapa kësaj letre është fruti i një reflektimi mbi parandalimin e evenimenteve të papëlqyera. Për të vërtetuar se i ka kuptuar drejtë dhe i përmbush të gjitha kushtet për të përdorur këtë mjet informatik, çdo nxënës duhet ta nënshkruajë këtë kartë. Sejcili nga prindërit ftohet ta ndjekë këtë përçapje për të qënë i vëmëndshëm, duke nënshkruar po ashtu, mbi këtë dokument. Autorët mendojnë se kjo mënyrë të vepruari ofron gjithashtu mundësinë për të favorizuar një diskutim familjar mbi përdorimin e internetit në shtëpi.

Disa shkolla animojnë po ashtu edhe site web. Këto site përmbajnë, midis të tjerash, faqe që përshkruajnë jetën brënda shkollës dhe klasës. Në mënyrë që këto site të kenë mundësi të ilustrojnë aktivitetet dhe projektet në vijim, është e dëshirueshme të behet edhe publikimi i fotografive dhe punëve që bëjnë nxënësit. Për këtë arsye, është e domosdoshe që edhe ju të jeni dakort me përdorimin e fotografive ku fëmija juaj dallohet qartë (me përjashtim të fotografive portret) ose të punëve të realizuara prej fëmijës tuaj.

#### **Shkolla angazhohet:**

- të publikojë vetëm fotografi të bazuara në respektin ndaj nxënësve dhe mësuesve të tyre.
- të përmendë vetëm emrin e nxënësit për të gjitha dokumentat (tekste, fotografi, zë, video...)

---

#### **Për nxënësin :**

Unë e njoh përmbajtjen e K@rtës informatike të RPN ([www.rpn.ch/charte](http://www.rpn.ch/charte)), dhe angazhohem ta respektoj.

Nxënësi (firma): ..... Vëndi dhe data : .....

#### **Për prindërit ose përfaqësuesit legalë:**

Ne jemi njohur me K@rtën Informatike të RPN-së dhe mbështesim rregullat për funksionimin e mirë që ajo përmban. Ne e kemi të qartë po ashtu, që në çdo kohë mund të kërkojmë heqjen e një fotografie ose të një prodhimi të veçantë, nëqoftëse publikimi i tij na shqetëson ne ose fëmijën tonë. Ne mund ta tërheqim po ashtu autorizimin tonë të përgjithshëm duke kontaktuar mësuesin-en.

Për prindërit (firma): ..... Vëndi dhe data: .....

**Ju falenderojmë për firmosjen e k@rtës Informatike te RPN , duke ju lutur t'ja dorëzoni mësuesit-es të fëmijës tuaj i (e) cili do t'ua kthejë përsëri, sapo të jetë njohur me vendimin tuaj.**

Për më shumë të dhëna : [www.rpn.ch/charte](http://www.rpn.ch/charte)

Gusht 2011